

UDHËZIM
Nr. 16, datë 8.6.2026

**PËR TARIFAT PËR MIRATIMIN E TRUPAVE TË KONTROLLIT DHE
NJOFTIMIN E AKTIVITETIT NGA TRUPAT E KONTROLLIT, QË VEPROJNË NË
SHQIPËRI SIPAS STANDARDEVE TË TJERA PËR PRODHIMIN ORGANIK**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 11, të nenit 45, të ligjit nr. 104/2024, “Për prodhimin organik, etiketimin e produkteve organike dhe kontrollin e tyre”,

UDHËZOJ:

Neni 1
Qëllimi

Ky udhëzim përcakton tarifat për:

- a) Miratimin e trupave të kontrollit që kryejnë inspektimin dhe certifikimin e operatorëve organikë në Republikën e Shqipërisë, sipas ligjit nr. 104/2024, “Për prodhimin organik, etiketimin e produkteve organike dhe kontrollin e tyre”;
- b) Njoftimin e aktivitetit të trupave të kontrollit që kryejnë inspektimin dhe certifikimin e operatorëve organikë në Republikën e Shqipërisë sipas standardeve të tjera për prodhimin organik.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Ky udhëzim zbatohet për të gjitha trupat e kontrollit, vendas ose të huaj, që ushtrojnë aktivitetin në territorin e Republikës së Shqipërisë në fushën e inspektimit dhe certifikimit të operatorëve organikë.

Neni 3
Tarifat

Tarifa e pagesës për trupat e kontrollit që paraqesin aplikimin në Komisionin për Prodhimin Organik (KPO):

- a) Për miratim, ndryshim të fushës së miratimit ose rinovim të miratimit për inspektimin dhe certifikimin e operatorëve organikë sipas ligjit nr. 104/2024, “Për prodhimin organik, etiketimin e produkteve organike dhe kontrollin e tyre”;
- b) Për njoftimin e aktivitetit për inspektimin dhe certifikimin e operatorëve organikë sipas standardeve të tjera për prodhimin organik të jetë 60 000 lekë (gjashtëdhjetë mijë) lekë.

Neni 4
Mënyra e pagesës

- 1. Pagesat kryhen në llogarinë e të ardhurave në bankat e nivelit të dytë, për llogari të ministrisë përgjegjëse për bujqësinë.
- 2. Dokumenti i pagesës depozitohet pranë KPO-së, së bashku me aplikimin.
- 3. Administrimi i të ardhurave që krijohen nga veprimtaria e Komisionit për Prodhimin Organik bëhet sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 432, datë 28.6.2006, “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore”, si dhe të udhëzimit të përbashkët të ministrit të Financave dhe të ministrit përgjegjës për bujqësinë nr. 1, datë 24.10.2006, “Për përdorimin e të ardhurave dytësore”, të ndryshuar.

Neni 5

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet më datë 29 tetor 2026.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla